LIGJ
Nr. 38/2015

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8831, DATË 22.11.2001, "PËR PRONËSINË SHTETËRORE NË SHOQËRITË TREGTARE FINANCIARE ME KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8831, datë 22.11.2001, "Për pronësinë shtetërore në shoqëritë tregtare financiare me kapital tërësisht shtetëror", bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 1

1. Ministria e Financave, e përfaqësuar nga ministri, vepron në emër të shtetit dhe është pronare e bankave tregtare shtetërore dhe e institucioneve financiare jobankare.

2. Ministri përgjegjës për ekonominë vepron në emër të shtetit dhe është pronar i shoqërive shtetërore të sigurimit, të cilat janë me kapital tërësisht shtetëror.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.4.2015

Shpallur me dekretin nr. 9061, datë 27.4.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani